

DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR

PROCEDURËN E HAPUR

MALLRA¹²

MBI KUFIRIN E LARTE MONETAR

“BLERJE PAJISJE MOBILIMI PËR NJËSITË SHPENZUESE TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”

REF-92869-07-08-2026

Fondi limit: Fondi limit total i marrëveshjes kuadër 12-mujore është **112,103,157 (njëqind e dymbëdhjetë milion e njëqind e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe 1,192,079.5 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e nëntë pikë pesë) Euro pa TVSH**, i ndarë si më poshtë vijon:

- Fakulteti i Mjekësisë 103,124,389 (njëqind e tre milion e njëqind e njëzet e katër mijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH dhe 1,096,601.3 (një milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e një pikë tre) Euro pa TVSH.
- Fakulteti i Mjekësisë Dentare 813,536 (tetëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 8,651 (tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) Euro pa TVSH.
- Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë 8,165,232 (tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH dhe 86,827.2 (tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëzetë e shtatë pikë dy) Euro pa TVSH.

*Shënim: Vlerat në Lekë janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqiperisë me datë 08.07.2026, me kurs këmbimi 94.04 (nëntëdhjetë e katër pikë katër) lekë.

NJËSIA E PROKURIMIT:

¹ Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash, Autoriteti /Enti kontraktor do t'i referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.

² Seti i Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë hartohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet variantit të setit në gjuhën shqipe me variantin në gjuhën angleze, do të merret për bazë seti në gjuhën shqipe.

NJOFTIME

NJOFTIMI PARAPRAK I INFORMACIONIT/ NJOFTIMI PERIDIOK I INFORMACIONIT

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Entit Kontraktor nëse aplikohet)

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor;

Emri _____

Adresa _____

1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror

☐

Njësi e autoriteteve vendore

☐

Institucioni i pavarur

☐

Të tjera

☐

1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta

☐

I deleguar

☐

Organ Qendror blerës

☐

Ofrues shërbimi

Publik ☐ Privat ☐

Të tjera

☐

1.4 Emri dhe adresa e personit të kontaktit:

Personi (at) përgjegjës për prokurimin: _____

Tel/faks _____

E-mail _____

1.5 Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

1.6 Lloji i procedurës së prokurimit: _____

1.7 Tipi i kontratës: _____

1.8 Fondi limit i përlogaritur për këtë kontratë/marrëveshje kuadër/Fondi limit i përlogaritur për këtë objekt siç është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit/Entit Kontraktor (në rastin e marrëveshjeve kuadër ose kontratave shumëvjeçare):

1.9 Kohëzgjatja e përafërt e kontratës/marrëveshjes kuadër: _____

1.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe/ose Lotit (eve), nëse përdoren:

1.11. Lloji i Marrëveshjes Kuadër, nëse është rasti:

1.12 Kohën e përafërt për zhvillimin e procedurës së prokurimit:

1.13 Informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm nga autoriteti/enti kontraktor:

NJOFTIMI I KONTRATËS
(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

Seksioni 1: Autoriteti/Enti Kontraktor**1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

Name:	Universitu of Medicine,Tirana
Address:	Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005, Tiranë
Tel/Fax:	-
E-mail:	prokurime@umed.edu.al
Website address:	www.umed.edu.al
Person(s) responsible for the procurement (name, e-mail)	Venora Isufi prokurime@umed.edu.a

1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror	Institucioni i pavarur
☐	☐
Njësi e autoriteteve vendore	Të tjera
☐	X

1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/Ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta	Organ Qendror blerës	Ofrues shërbimi
☐	☐	Publik ☐ Privat ☐
I deleguar	Të tjera	
☐	X	

1.4. Kontratë në bazë të një marrëveshje të posaçme midis Shqipërisë dhe një shteti tjetër:

Po	☐	Jo	X
-----------	--------------------------	-----------	----------

1.5 Kontrate që bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar:

Po☐**Jo****X****1.6 Kontratë e rezervuar :****Po**☐**Jo****X**

Seksioni 2: Objekti i Kontratës: “BLERJE PAJISJE MOBILIMI PËR NJËSITË SHPENZUESE TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”

2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) REF-92869-07-08-2026

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) 39100000-3 - Mobilje, 39130000-2 - Mobilje për zyra, 39150000-8 - Mobilje dhe pajisje të ndryshme.

2.3 Lloji i “Kontratës Publike për furnizim”

Blerje

Marrje
me qira

Blerje me këste

Një kombinim i tyre

X☐☐☐**2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:****Po****X****Jo**☐**2.5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër:****Me një Operator Ekonomik****X****Me disa Operatorë Ekonomikë**☐**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara** Po ☐ Jo ☐**2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:**

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes:

Autoriteti Kontraktor ka vendosur lidhjen e Marrëveshjes Kuadër me një operator ekonomik, pasi të gjitha kushtet e kontratës janë të përcaktuara paraprakisht dhe natyra e objektit të prokurimit kërkon një furnizim të unifikuar, të koordinuar dhe të realizuar brenda një afati të kufizuar.

Objekti i prokurimit përfshin furnizimin me pajisje mobilimi për katër njësi përfituese, konkretisht:

- Fakultetin e Mjekësisë (Godina e Anatomisë në QSUT , Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik)
- Fakultetin e Mjekësisë Dentare;

- Universiteti I Mjekësisë, Tiranë (Rektorati).

Për shkak të natyrës së furnizimit, ku kërkohet që mobilimi të jetë i standardizuar për sa i përket cilësisë, materialeve, ngjyrave, karakteristikave teknike dhe përfundimeve estetike, realizimi i kontratës nga një operator i vetëm ekonomik garanton uniformitetin e pajisjeve në të gjitha njësitë përfituese.

Gjithashtu, afati i lëvrimin është përcaktuar **45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike nga momenti i nënshkrimit të minikontratave**, çka kërkon koordinim të centralizuar të prodhimit, furnizimit, transportit dhe montimit. Angazhimi i më shumë se një operatori ekonomik do të rriste rrezikun e vonesave në ekzekutimin e kontratave, mospërputhjes së karakteristikave teknike dhe estetike të mobilimit, si dhe do të vështirësonte koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Për këto arsye, lidhja e Marrëveshjes Kuadër me një operator ekonomik konsiderohet zgjidhja më efikase, pasi garanton administrim më të mirë të kontratës, përgjegjësi të qartë kontraktore, standardizim të furnizimit dhe realizimin në kohë të objektit të prokurimit për të gjitha njësitë përfituese.

2.7 Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë:

Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: ____ (Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër)

2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:

--	--	--

2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore ose Enti/Entet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër: (këtu duhet të listohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore që do të jenë palë përfituese nga marrëveshja kuadër)

2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës:

Fondi limit: Fondi limit total i marrëveshjes kuadër 12-mujore është **112,103,157 (njëqind e dymbëdhjetë milion e njëqind e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe 1,192,079.5 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e nëntë pikë pesë) Euro pa TVSH**, i ndarë si më poshtë vijon:

- Fakulteti i Mjekësisë 103,124,389 (njëqind e tre milion e njëqind e njëzet e katër mijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH dhe 1,096,601.3 (një milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e

gjashtëqind e një pikë tre) Euro pa TVSH.

- Fakulteti i Mjekësisë Dentare 813,536 (tetëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 8,651 (tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) Euro pa TVSH.
- Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë 8,165,232 (tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH dhe 86,827.2 (tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëzetë e shtatë pikë dy) Euro pa TVSH.

*Shënim: Vlerat në Lekë janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqiperisë me datë 08.07.2026, me kurs këmbimi 94.04 (nëntëdhjetë e katër pikë katër) lekë.

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është _____ (Monedha), pa TVSH.**
3. Burimi i financimit: Vetëfinancim
4. Kodi Output: 0000000
5. Tipi:

Investime X Kodi: 230 Vlera: **112,103,157 (njëqind e dymbëdhjetë milion e njëqind e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe 1,192,079.5 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e nëntë pikë pesë) Euro pa TVSH**

Shërbime ☐ Kodi: _____ Vlera: _____

2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Kohëzgjatja në muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër

ose ditë 45 ditë nga dita e nënshkrimit të minikontratave

Ose

Fillon më □□/□□/□□□□ mbaron më □□/□□/□□□□

2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:

Kohëzgjatja në muaj: 12 ose ditë: _____ (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër)

Ose fillon më _____/_____/_____ (d/m/v)

mbaron më _____/_____/_____ (d/m/v)

2.12 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës:

Fakulteti i Mjekësisë- Godina e Anatomisë në QSUT , Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik - Adresa: Pranë QSUT-së, Rruga e Dibrës, Tiranë

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (Rektorati) - Rruga e Dibrës , Tiranë**Fakulteti i Mjekësisë Dentare. Tiranë – Rruga e Dibrës, Tiranë****2.13 Ndarja në Lote:****Po****Jo****X***Nëse po,*

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Universiteti i Mjekësisë, Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e mosndarjes së procedurës në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Kjo procedurë është e pamundur teknikisht të ndahet në lote sepse nga vete objekti i prokurimit kemi të bëjmë me një furnizim mallrash të cilat klasifikohen në të njëjtën familje të mallrave objekt prokurimi. AK gjykon se ndarja në lote e kontratës së mësipërme nuk është praktike, pasi furnizimi i kërkuar nuk mund të copëzohet

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 parashikohet shprehimisht se:
“Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 14, Operatorët ekonomikë, parashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e minikontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës.

Në këto kushte, duke qënë se kemi të bëjmë me të njëjtën familje mallrash si dhe furnizimi i kërkuar nuk mund të copëzohet për shkak se është një artikull i vetëm gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Theksojmë se kjo procedurë është një procedurë e cila është kërkuar në mënyrë të përvitshme nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë dhe për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash ndër vite dhe është e përqendruar në një kontratë.

2.14 Përshkrimi i shkurtër i Loteve:

(objekti dhe fondi limit për secilin Lot)

1. _____

2. _____

2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:

☐ një Lot,

- ☐ disa Lote,
- ☐ të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues:

Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t'i jepen një ofertuesi _____

2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

2.14.4 Kombinimi i Loteve në një kontratë/kontrata të përbashkëta (Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një Lot):

Po ☐ Jo ☒

Nëse po, specifikoni grupin e Loteve që mund të kombinohen.

2.15 Pranohen variantet:

Po ☐ Jo ☒

2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:

Po ☐ Jo ☒

Nëse lejohet nënkontraktimi, specifikoni përqindjen e lejuar për nënkontraktim:

(nuk lejohet nënkontraktimi në një masë më të madhe se 50 % e vlerës së kontratës)

2.15.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të kryejë pagesa direkte tek nënkontraktori:

Po ☐ Jo ☒

Shënime të tjera (nëse vlerësohen të nevojshme nga autoriteti/enti kontraktor)

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po**X****Jo**☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë nga dispozitat e sipërpërmendura të çdo kriteri të vendosur dhe të mire argumentuar sipas ligjit, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt -prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Përsa i përket xhiros vjetore sipas ligjit të prokurimit publik i cili përcakton në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga Njësia e Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë, pra është një vlerë proporcionale dhe minimaliste referuar vlerës së objektit të kontës që po prokurohet , mbështetur në frymën e Ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Neni 2 “Qëllimi i ligjit”, gërmat c), ç), d), Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, pika 1, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, si dhe përfitimin e një malli cilësor duke qenë në përputhje me dispozitat ligjore.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

Përsa i përket kriterit 2.3.1 nuk lejohet kapacitetet mbështetës ky kriter është vendosur referuar nenit n 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit për te pakten një kontratë të vetme. Përqindja e kërkuar jo më e vogël se 39% është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës. Ky kufizim është i nevojshëm pasi përvoja e mëparshme duhet të pasqyrojë aftësinë reale të operatorit ekonomik për të organizuar dhe realizuar procese të ngjashme prodhimi dhe montimi.

Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.” III.2.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. III.2.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4

të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Pikat **2.3.2, 2.3.3** nuk lejohet kapacitet mbështetës referuar nenit 77, “Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 5/b/c, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, në mbështetje të Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të Vendimit nr. 514, datë 20.09.2017, “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar”, si dhe të Urdhrit nr. 99, datë 25.05.2021, “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”, është parashikuar kriteri që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponimin e stafit dhe personelit të nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa për punonjës të specializuar lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi një pjesë e konsiderueshme e artikujve të kërkuar përbëhet nga mobilje druri ose materiale të ngjashme, të cilat do të prodhohen, montohen dhe asamblohen në përputhje të plotë me përmasat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike përfaqësojnë elementët kryesorë që garantojnë cilësinë e produkteve dhe përmbushjen e funksioneve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Në këtë mënyrë, argumentimi për domosdoshmërinë e stafit të kualifikuar dhe numrin total të punonjësve të cilët janë vetëm 25 referuar objektit të kontratës dhe vlerës që ka ky object është një numër minimal punonjësish të cilët mund ti disponojnë dhe operatorët e rinj në treg dhe nuk ka nevojë që OE të mbështet në subjekte të tjera si dhe bazohet në sigurimin e një realizimi cilësor të objektit të prokurimit, duke garantuar jo vetëm përputhjen me kuadrin ligjor dhe rregullator, por edhe me kërkesat funksionale dhe estetike të Autoritetit Kontraktor përfitues për më tepër afati i realizimit kohor është i vogël dhe të gjithë punonjësit e kërkuar do të punojnë zinxhir në të gjitha godinat e kërkuara në mënyrë që të përfundojnë benda afateve kohore dhe puna zinxhir lidhet me prodhimin, montimin, heqjen, shkarkimin e të gjitha materialeve të kërkuara sipas zërave përkatës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës dhe për më tepër është bërë llogaritja

e numrit të punonjëse dhe ata do të shpërndahen në të gjitha godinat e kërkuara për të punuar për montimin e mobiljeve dhe montimin e atyre ekzistuese si dhe punonjesit e kualifikuar lidhen dhe me prodhimin e tyre të cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

Kapaciteti mbështetës nuk lejohet për pikën **2.3.4-** Autoriteti Kontraktor vlerëson se certifikatat **ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018** përfaqësojnë sisteme të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit e sigurisë në punë, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me organizimin, proceset e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të operatorit ekonomik që do të realizojë kontratën. Këto certifikata nuk dëshmojnë vetëm disponimin e një dokumenti formal, por vërtetojnë se vetë operatori ekonomik zbaton procedura të standardizuara për menaxhimin e proceseve të prodhimit, kontrollin e cilësisë, mbrojtjen e mjedisit dhe garantimin e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin prodhimin, transportin dhe montimin e mobiljeve, Autoriteti Kontraktor çmon se është e domosdoshme që këto sisteme menaxhimi të zbatohen nga vetë operatori ekonomik që do të ekzekutojë kontratën dhe jo nga një subjekt i tretë. Për këtë arsye, nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera për plotësimin e këtij kriteri, pasi certifikatat ISO duhet të pasqyrojnë funksionimin dhe organizimin e operatorit ekonomik që merr përsipër realizimin e kontratës.

Për kriteret **2.3.5 dhe 2.3.6** nuk lejohet mbështetja në kapacite të tjera mbështetëse

Për pikën 2.3.5 - Autoriteti Kontraktor vlerëson se disponimi i mjeteve të transportit nga vetë operatori ekonomik është një kërkesë thelbësore për realizimin e kontratës, pasi objekti i prokurimit përfshin jo vetëm prodhimin, por edhe transportin dhe dorëzimin e mobiljeve në vendet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Mjetet e transportit janë të domosdoshme për garantimin e shpërndarjes së mallrave në afatet e përcaktuara, ruajtjen e integritetit të tyre gjatë transportit dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktore. Kërkesa është hartuar në mënyrë proporcionale dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi Autoriteti Kontraktor ka kërkuar mjete transporti me **kapacitet mbajtës min në 3.5 ton**, të përshtatshme për transportin e mobiljeve objekt prokurimi. Kjo kërkesë nuk favorizon asnjë kategori të caktuar operatorësh ekonomikë dhe nuk përbën barrierë për pjesëmarrje, pasi mjete të tilla janë mjete standarde transporti, të zakonshme në veprimtarinë e operatorëve ekonomikë që ushtrojnë aktivitet në fushën e prodhimit dhe furnizimit me mobilje.

Gjithashtu, kriteri nuk është diskriminues, pasi Autoriteti Kontraktor ka lejuar që mjetet të disponohen **si në pronësi, ashtu edhe në bazë të kontratës së qirasë**, duke zgjeruar mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë. Çdo operator ekonomik me përvojë dhe aktivitet të konsoliduar në tregun e prodhimit dhe furnizimit të mobiljeve disponon ose ka mundësinë reale të disponojë mjete të tilla transporti për realizimin e kontratës.

Për këto arsye, Autoriteti Kontraktor vlerëson se disponimi i mjeteve të transportit përbën një kapacitet teknik thelbësor që duhet të jetë në dispozicion të drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës dhe, për këtë kriter, nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Për pikën 2.3.6- Autoriteti Kontraktor vlerëson se makineritë dhe pajisjet e kërkuara përbëjnë kapacitetin bazë prodhues për realizimin e objektit të prokurimit dhe janë të lidhura drejtpërdrejt me procesin e prodhimit të mobiljeve sipas specifikimeve teknike. Makinaria prerëse automatike, bordatricja, pantografi CNC, kabina e lyerjes, freza dhe presa multifunksionale janë pajisje

thelbësore për realizimin e proceseve të prerjes, përpunimit, formimit, lyerjes dhe montimit të elementëve të mobiljeve, duke garantuar cilësinë, saktësinë dhe respektimin e standardeve teknike të kërkuara.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor vlerëson se këto makineri dhe pajisje duhet të disponohen drejtpërdrejt nga operatori ekonomik që do të ekzekutojë kontratën dhe nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera. Ky kufizim është proporcional me natyrën e kontratës dhe synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetin real prodhues gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të saj.

Për pikën 2.3.7 –Kërkesa për paraqitjen e deklaratës mbi periudhën minimale 1 (një) vjeçare të garancisë është vendosur për të garantuar se operatori ekonomik ofertues do të mbajë përgjegjësi të plotë për cilësinë e mallrave të furnizuara dhe për riparimin ose zëvendësimin e çdo defekti që rrjedh nga procesi i prodhimit ose montimit. Duke qenë se garancia përbën një detyrim kontraktor që lidhet drejtpërdrejt me përgjegjësinë e operatorit ekonomik që do të ekzekutojë kontratën, kjo kërkesë nuk mund të përmbushet nëpërmjet mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Për pikën 2.3.8 – Kërkesa për paraqitjen e deklaratës me anë të së cilës operatori ekonomik merr përsipër kryerjen e transportit, montimit dhe vendosjes së mobiljeve në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor është vendosur për të garantuar realizimin e plotë të objektit të kontratës. Këto shërbime përbëjnë pjesë integrale të kontratës dhe lidhen drejtpërdrejt me përgjegjësinë e operatorit ekonomik për ekzekutimin e saj. Për këtë arsye, ky angazhim duhet të merret nga vetë operatori ekonomik ofertues dhe nuk mund të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Për pikën 2.3.9 –Kërkesa për paraqitjen e deklaratës që konfirmon se mallrat objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë, të prodhuara sipas standardeve të cilësisë në fuqi dhe pa dëmtime estetike apo strukturore është vendosur për të garantuar përputhshmërinë e mallrave me specifikimet teknike dhe cilësinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Kjo deklaratë përbën një angazhim të drejtpërdrejtë kontraktor të operatorit ekonomik, i cili mban përgjegjësi për cilësinë dhe konformitetin e mallrave të furnizuara. Për rrjedhojë, ky detyrim nuk mund të përmbushet nëpërmjet mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera.

"Këto deklarata duhet të nënshkruhen dhe të merren përsipër nga vetë operatori ekonomik ofertues, pasi përfaqësojnë angazhime kontraktore personale ndaj Autoritetit Kontraktor."

Autoriteti Kontraktor vlerëson se lejimi i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera do të krijonte pasiguri mbi disponueshmërinë reale të kapaciteteve të kërkuara gjatë ekzekutimit të kontratës, do të rriste rrezikun për mosrespektimin e afateve, cenimin e cilësisë së produkteve dhe vështirësinë në garantimin e përgjegjësisë kontraktore. Për rrjedhojë, këto kufizime janë vendosur në mënyrë proporcionale, në funksion të mbrojtjes së interesit publik dhe sigurimit të realizimit me cilësi të kontratës referuar objektit të prokurimit dhe vlerës së këtij objekti për të cilin prokurohet.

Përsa më sipër cituar AK gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentet e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e

natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Referuar testit të proporcionalitetit vendosja e kriterëve nga ana e autoritetit kontraktor duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm i kriterëve të vendosura dhe realizimit me sukses të kontratës. Autoritetit kontraktor referuar faktit se duke qenë se fryma e Ligjit të Prokurimit Publik bazohet në këto parime: “mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, kriteret për kualifikim janë hartuar në mënyrë të tillë që të jenë gjithëpërfshirëse dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

2.17 Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po ☐ Jo ☒

2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po ☐ Jo ☒

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: 2,242,063.14 (dy milion e dyqind e dyzetë e dy mijë e gjashtëdhjetë e tre pikë katërmëdhjetë) lekë ose 23,841.59 **euro** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më 08.07.2026 është 94.04 lekë/euro.

(e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se se prokurimi me vlerë të vogël).

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është : **2,242,063.14** (dy milion e dyqind e dyzetë e dy mijë e gjashtëdhjetë e tre pikë katërmëdhjetë) lekë ose 23,841.59 **euro**, Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më 08.07.2026 është 94.04 lekë/euro.
(shuma e shprehur me fjalë).

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 _____ (shuma,monedha)

Loti 2 _____ (shuma monedha)

3.1.2 Autoriteti/Enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor 4662101 (të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor)

3.1.3 Autoriteti/Enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

- i. garancisë bankare ☒ ose
- ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente ☒

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 (njëqind e pesëdhjetë) (shprehur në ditë)

Seksioni 4: Procedura

4.1. Lloji i procedurës: “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar-Mallra”

4.2. Është përdorur njoftimi paraprak/periodik i informacionit:

Po ☐ **Jo** ☒

Nëse Po, numri i referencës është _____

4.2.1. Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave (e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).

Po ☐ **Jo** ☒

4.3 Procedurë e rishpallur:

Po ☐ **Jo** ☒

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit _____

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit _____

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____ (shuma , monedha)

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) ³Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ☐

Sipas rëndësisë:

çmimi ☐ pikët ☐

_____ ☐ pikët ☐

³ Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

_____ ☐ ☐ pikët ☐ ☐

_____ ☐ ☐ pikët ☐ ☐

Autoriteti/ Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

OSE

B) oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim X

Në rastin e marrëveshjes kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi

(Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: **10/08/2026** (d/m/v) ora **10:00**

Vendi: në faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.

4.6 Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave, sipas parashikimeve në nenin 42, pika 6, të LPP (e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).

Po



Jo X

Nëse po, argumentoni arsyet e shkurtimit të këtij afati:

--

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip X

Anglisht X

Seksioni 5: Informacione shtesë:

5.1 Dokumente me pagesë (zbatohet vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):

Po



Jo

X

Nëse po

Monedha**Çmimi**

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së Dokumenteve të Tenderit (DT) tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të konsultojnë DT përpara blerjes së tyre.

5.2 Informacione shitesë (vendi, zyra, mënyra e blerjes së dokumenteve të tenderit (kur është e aplikueshme)

Operatori ekonomik fitues, për nënshkrimin e një kontrate publike duhet të ketë:

- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softuerike.

Data e dorëzimit të këtij njoftimi

08/07/2026

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër në rihapjen e procesit të mini-konkurrrimit]

FTESE PËR OFERTË

(shënoni emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor) fton për paraqitjen e ofertave në procedurën për furnizimin e mallrave në vijim:

.....
.....
.....

jepni një përshkrim të saktë të mallrave dhe sasisë konkrete të kërkuar:

Vendi i dorëzimit të mallrave: (jepni një përshkrim të shkurtër) _____

Koha e dorëzimit/lëvrimit: Mallrat duhet të dorëzohen brenda datës _____

Ofertat duhet të paraqiten në:

.....[jepni adresën e saktë]

Afati i fundit për pranimin e ofertave:

.....

[Përcaktoni datën dhe orën]

Kriteret për përcaktimin e ofertës fituese _____

Forma e komunikimit:

Forma shkresore ☐

Forma elektronike (e-mail, faks, etj.) ☐

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

*(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor, për publikim në
Buletinin e Njoftimeve Publike)*

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri: Universiteti Mjekësisë, Tiranë

Adresa: Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005, Tiranë

Tel/Faks:

E-mail: prokurime@umed.edu.al

Web-faqe: www.umed.edu.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur, mbi kufirin e latë monetar-Mallra, marrëveshje kuadër 12 (dymbëdhjetë) mujore, me një operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-92869-07-08-2026

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “BLERJE PAJISJE MOBILIMI PËR NJËSITË SHPENZUESE TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 39100000-3 - Mobilje, 39130000-2 - Mobilje për zyra, 39150000-8 - Mobilje dhe pajisje të ndryshme.

6. Fondi limit: Fondi limit total i marrëveshjes kuadër 12-mujore është **112,103,157 (njëqind e dymbëdhjetë milion e njëqind e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe 1,192,079.5 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e nëntë pikë pesë) Euro pa TVSH**, i ndarë si më poshtë vijon:

- Fakulteti i Mjekësisë 103,124,389 (njëqind e tre milion e njëqind e njëzet e katër mijë e treqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH dhe 1,096,601.3 (një milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e një pikë tre) Euro pa TVSH.
- Fakulteti i Mjekësisë Dentare 813,536 (tetëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe 8,651 (tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një) Euro pa TVSH.
- Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë 8,165,232 (tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH dhe 86,827.2 (tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëzetë e shtatë pikë dy) Euro pa TVSH.

*Shënim: Vlerat në Lekë janë konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë me datë 08.07.2026, me kurs këmbimi 94.04 (nëntëdhjetë e katër pikë katër) lekë.

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Afati i Marrëveshjes Kuadër do të jetë 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër. Lëvrimi i mallrave do të bëhet 45 ditë kalendarike nga dita e nënshkrimit të minikontratave.

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 10.08.2026 Ora: 10:00

9. Procedurë e Rishpallur:

Po



Jo

X

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit _____

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit _____

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____ (shuma , monedha)

[Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I

KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

☐ Mallra:		
Numri i përafërt i kontratave të planifikuara për t'u dhënë në bazë të Marrëveshjes Kuadër _____		
Numri i kontratës	Titulli i kontratës	Përshkrimi i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shënim: Ky planifikim është i përafërt bazuar në nevojat që mund të ketë autoriteti/enti kontraktor dhe orientues për palët në proces.

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Faks _____
E-mail _____
Ueb-faqe _____

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri _____
E-mail _____

3. Lloji i procedurës së prokurimit: _____

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër: _____

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: _____

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _____

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): _____

8. Fondi limit : _____

9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar: _____

Shënim:

Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

**NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË
ZBATIMIT**

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri _____
Adresa _____
Tel/Faks _____
E-mail _____
Ueb-faqe _____

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri _____
E-mail _____

3. Lloji i procedurës së prokurimit: _____

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes Kuadër:_____

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin:_____

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër :_____

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):_____

8. Fondi limit: _____

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e mallrave:

11.Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: _____

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti):_____

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: _____

Dhe afati i ri (nëse është rasti): _____

14. Emri dhe adresa e Operatorit/ëve Ekonomikë:

Emri_____

NIPT: _____

Adresa _____

Kontaktet _____

15. Data e nënshkrimit të modifikimit : _____

16. Burimi i financimit: _____

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor _____

DOKUMENTAT E TENDERIT

Përmbajtja:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë (Udhëzime)

